

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR.9220, DATË 19.5.2008, “PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektligj ka si qëllim adresimin e njërit prej rekomandimeve të Komitetit të Ekspertëve për Vlerësimin e Masave Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (*Moneyval*), të Këshillit të Evropës, lidhur me përdorimin e parasë fizike dhe reduktimin e ekonomisë informale.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj nuk është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2019.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Në kuadër të procesit të vlerësimit nga Komiteti *Moneyval* i Këshillit të Evropës, me publikimin e raportit të vlerësimit, Shqipërisë i është lënë një vit kohë për përmbushjen e rekomandimeve dhe adresimin e problematikave të evidentuara në raport. Raporti synon vlerësimin e përputhshmërisë të kuadrit ligjor e rregullativ në vend për çështjet e pastrimit të parave (PP) dhe financimit të terrorizmit (FT), me 40 rekomandimet e FATF-së, të cilat njihen si standard detyrues e unifikues në rang botëror për këto çështje. Gjithashtu, vlerësohet paralelisht edhe efektiviteti i sistemit në parandalimin dhe luftën ndaj këtyre fenomeneve.

Në datën 4 shtator 2018, Komiteti për Bashkërendimin e Luftës Kundër Pastrimit të Parave (KBLKPP), nën drejtimin e Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, ka miratuar planin e veprimit, duke caktuar për çdo masë afate dhe institucione përgjegjëse.

Në zbatim të masave të planit dhe rekomandimeve të raportit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka iniciuar këtë projektligj, parashikimet e të cilit janë diskutuar dhe dakordësuar më herët në grupin e punës të ngritur me urdhrin nr.286, datë 25.10.2018, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, “Për ngritjen e grupit të punës, për ndjekjen, koordinimin dhe raportimin e progresit të masave të përcaktuara në planin e veprimit, për përmbushjen e rekomandimeve të komitetit të ekspertëve për vlerësimin e masave kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (*Moneyval*) të Këshillit të Evropës”.

Një ndër masat e parashikuara në kuadër të këtij plani, lidhet me reduktimin e ekonomisë informale dhe përdorimit të parasë fizike nga personat fizikë/juridikë tregtarë. Për këtë qëllim, duke adresuar njëkohësisht rekomandimet e Komitetit *Moneyval*, propozohet të sanksionohet në ligjin për procedurat tatimore, detyrimi i të gjithë tatimpaguesve persona fizikë/juridikë, përfshirë edhe organizatat jofitimprurëse për të pasur llogari bankare biznesi. Ndërkohë, parashikohet që mos të jenë subjekte të këtij detyrimi tatimpaguesit, persona fizikë tregtarë të cilët realizojnë qarkullim vjetor, rrjedhimisht edhe qarkullim të parasë fizike, në vlera të ulëta. Për këtë arsye, është marrë për referencë, kufiri i regjistrimit për përgjegjësinë tatimore: tatimi mbi vlerën e shtuar. Sjellim në vëmendjen tuaj se, sipas ligjit nr.92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, neni 117, dhe në vendimin nr.953, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, neni 11, nuk janë subjekt i detyrimit për t’u regjistruar për TVSH-në, tatimpaguesit të cilët realizojnë një qarkullim vjetor (përveç atyre që ushtrojnë veprimtari sipas profesioneve të përcaktuara në pikën 2, të nenit 11), më të vogël se 2 000 000 (dy milionë) lekë.

Gjithashtu, parashikohet vendosja e një afati të përcaktuar për përmbushjen e këtij detyrimi, si dhe dënimi në rast të mospërmbushjes së tij nga ana e tatimpaguesit.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrimin e legjislationit me ndonjë *Acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Me anë të këtij projektligji bëhen disa shtesa në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Projektligji përbëhet nga 3 nene.

Neni 1 parashikon që në nenin 59, pas pikës 1/1, të shtohet pika 1/2, e cila parashikon detyrimin e tatimpaguesve persona fizikë tregtarë, të regjistruar për tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH), për të disponuar llogari bankare të biznesit. Ndërkohë që për personat juridikë, ky detyrim shtrihet për të gjithë tatimpaguesit, përfshirë organizatat jofitimprurëse, pavarësisht qarkullimit që realizojnë.

Neni 2 parashikon që në nenin 120 shtohen disa paragrafë, të cilët përcaktojnë dënimet administrative në rast të mospërbushjes së detyrimit të parashikuar në nenin 1, të projektligjit, konkretisht:

- a) Tatimpaguesit persona fizikë tregtarë, të regjistruar për tatimin mbi vlerën e shtuar, me qarkullim deri në 8 000 000 (tetë milionë) lekë, gjobë, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;
- b) Tatimpaguesit persona juridikë, pavarësisht nga qarkullimi, si dhe tatimpaguesit persona fizikë tregtarë, me qarkullim mbi 8 000 000 (tetë milionë) lekë, gjobë, në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë;
- c) Organizatat jofitimprurëse, gjobë në masën 75 000 (shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë.

Gjithashtu, po në këtë dispozitë përcaktohen dhe afatet kohore për përmbushjen e detyrimit për pajisjen me llogari bankare të biznesit.

Neni 3 parashikon hyrjen në fuqi të ligjit 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij akti ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, administrata tatimore, si dhe tatimpaguesit e regjistruar në Republikën e Shqipërisë.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji nuk parashikon shpenzime shtesë në buxhetin e shtetit.

KËSHILLI I MINISTRAVE